

Në bazë të nenit 27, paragrafi 4 nga Ligji për financimin e njësisve të vetqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 61/2004) dhe neni 22, paragrafi 1 pika 4 nga Statuti i Komunës së Kërçovës, ("Fletorja zyrtare e NJV-së, Kërçovë nr. 5/06), Këshilli i Komunës së Kërçovës në mbledhje _____-të, të mbajtur më dt. ____01.2018 solli:

KALENDARIN BUXHETOR
të Komunës së Kërçovës për vitin 2018

Nr.rend.	Aktivitete	Përgjegjësi	Muaji i vitit
1	Këshilli i Komunës së Kërçovës e sjell kalendarin buxhetor	Ligji për financimin e NJVL-së neni 27 paragrafi 4 dhe 5 ("Gz.zyrtare nr. 61/04;96/04;67/07; 156/09)	Janar/ shkurt
2	Këshilli i Komunës e shqyrton dhe miraton strategjinë financiare të komunës	Seksioni për çështje financiare, Seksioni administrimin e të ardhurave dhe Seksion ZHEL-it	Prill-Maj
3	Bëhet zbatimit i plotë i të gjitha flukseve hyrëse dhe dalëse të buxhetit komunal kontroll funksional i planeve financiare dhe programeve zhvillimore dhe strategjia e përcaktuar fiskale.Konstatimet dhe të dhënat e fituara futen në raport të veçantë në mënyrë që i njëjti dorëzohet deri te të gjithë sektorët dhe shfrytëzuesit e buxhetit	Kryetari i Komunës, Seksioni për çështje financiare dhe Seksioni për administrimin e të ardhurave	Maj- Qershor
4	Të gjithë Sektorët dhe shrytëzuesit buxhetorë në Sekskonin për çështje financiare i dorëzojnë planet financiare dhe propozimet e llogarive për vitin në vazhdim me arsyetim për lartësinë e disa pozicioneve	Udhëheqësit e shrytëzuesëve buxhetorë dhe udhëheqësit e sektorëve të komunës	Më se voni deri në 20 shtator
5	Ministri për financa dorëzon qarkulluesin-orientimet për përgatitjen e buxhetit në njësitë e vetqeverisjes lokale për vitin në vazhdim dhe pas orientimeve të marra , Kryetari përgatit qarkulluesin buxhetor të komunës me drejtime kryesore për përgatitjen e planeve financiare dhe palneve për zhvillimin e programeve dhe strategjin të përcaktuar fiskale dhe e dorëzon deri te të gjitha Sektorët dhe shfrytëzuesit e buxhetit.	Ligji për buxhete, neni 21 (Gz. Zyrtare 64/05; 04/08; 103/08), Ligji për financimin e NJVL-së, neni 27, paragrafi 1 dhe 2 ("Gz. Zyrtare 61/04; 96/04; 67/07; 156/09)	Më së voni deri më 30 shtator
6	Kryetari i komunës organizon mbledhje të përbashkët me të gjithë seksionet në administratën e komunës me agjendë konkrete për procesin e buxhetimit-përcaktimit e përparësive për vitin e	Kryetari i Komunës, Udhëhesësit e sektorve dhe seksioneve	Më së voni deri më 30 shtator

	ardhshëm		
7	Në bazë të përparësive të caktura, sektorët dhe të gjithë seksionet tjera kompetente e përgatisin Propozimin e Planit në programe zhvillimore dhe si propozim nga kryetari i komunës dorëzohen për miratim në Këshill	Kryetari i komunës, Udhëheqësit e sektorëve dhe seksioneve	Më së voni deri më 20 tetor
8	Propozimi i Planit të programeve zhvillimore, shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli i Komunës së Kërçovës. Plani i miratuar për programet zhvillimore, do të jetë pjesë integrale e Propozimit të Buxhetit të komunës.	Këshilli i Komunës	Më së voni deri në 15 nëntor
9	Seksioni për Buxhet dhe Financa përgatit vlerësime për të ardhurat e përgjithshme i shqyrton, analizon dhe harmonizon propozimet e llogarive dhe planeve financiare, i cakton prioritetet dhe masat e reja të Propozimit të Buxhetit dhe njofton Kryetarin e komunës për parametrat e reja	Seksioni për çështje financiare	Tetor - Nëntor
10	Seksooni për çështje financiare e përgatit projektin e buxhetit dhe dorëzon te kryetari i komunës për shqyrtim dhe miratim	Kryetari i Komunës	Nëntor
11	Kryetari i Komunës dorëzon projektin e buxhetit deri në Këshillin e Komunës së Kërçovës dhe organizon Diskutim publik	Kryetari i Komunës	Nëntor
12	Kryetari i Komunës dorëzon Propozimin e Buxhetit në Këshillin e Komunës së Kërçovës	Kryetari i Komunës	Më së voni deri më 10 dhjetor
13	Zhvillohet diskutim lidhur me Propozimin e Buxhetit në komisionet e Këshillit të komunës	Komisioni për Financa dhe Buxhet	dhjetor
14	Këshilli i Komunës së Kërçovës e miraton Propozimin e Buxhetit për vitin në vazhdim	Këshilli i Komunës	Më së voni deri në 31 dhejtor

Kalendari buxhetor i Komunës së Kërçovës për vitin 2018 hyn në fuqi ditën e rradhës nga publikimi në "Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës".

Nr.- /
Dt. _____ .2018
K e r ç o v ë

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Aqif Mediu d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 nga Ligji për vetqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002) dhe neni 43 nga Statuti i Komunës së Kërçovës (Fletorja zyrtare e Komunës së Kërçovës" nr. 5/2006), Këshilli i Komunës së Kërçovës, në mbledhjen e mbajtur më dt. _____solli:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e përcaktimit të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2011

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i përcaktimit të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2011 dhe ajo në kte mënyrë:

Nënprogrami Kredi Nënshkalla	Buxheti	Akte me vetf.	Donacione	Dotacione
N20 Arsim i mesëm				
425760-Shërbime tran.	0	0	0	659 180 0
464910 Pagesa sipas				
Vendimeve gjyqësore	0	0	0	659 180 0
	0	0	0	0 0

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi me ditën e sjelljes dhe është pjesë përbërse e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2011, ndërsa do të publikohet në “Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës”.

Nr.07- _____
Dt. _____
K ë r ç o v ë

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Mr. Gjorgjija Sajkoski d.v.